



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS  
MINISTRI

Rruga: "Durrësit", Nr. 23, AL- 1001, Tiranë – SHQIPËRI

[www.mash.gov.al](http://www.mash.gov.al)

Tel: 00 355 4 225 678

Nr. Prot.  
Tiranë, 2007

**UDHËZIM**

*Nr.38, datë 09.10.2007*

**PËR**

**ZHVILLIMIN E ORËVE TË LIRA NË SHKOLLË**

Në zbatim të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Ligjit nr. 7952, datë 21.06.1995 "Për Sistemin Arsimit Parauniversitar", i ndryshuar

**UDHËZOJ:**

**KREU I**

**ZHVILLIMIN E ORËVE TË LIRA**

Çdo program lëndor përmban pjesën e quajtur "orë të lira", e cila zë 10% -15% të orëve totale. Në sistemin arsimor parauniversitar ato shprehen si më poshtë:

- a. Në arsimin bazë janë orët e lira të programit lëndor bashkë me orët për veprimtaritë ekstrakurrikulare.
- b. Në arsimin e mesëm, janë orët e quajtura "të lira" ose "në dispozicion".

**KREU II**

**PLANIFIKIMI I ORËVE TË LIRA**

Orët e lira mund të planifikohen për:

- a. Përforcimin e lëndëve të planit mësimor,
- b. Për provimet e Maturës Shtetërore,
- c. Projekte kurrikulare,
- d. Module mësimore,
- e. Lëndë me zgjedhje,
- f. Veprimtari të ndryshme shkollore,
- g. Vlerësime në nivel shkollë të arritjeve të nxënësve.

## KREU III

### PËRFORCIMI I LËNDËVE TË PLANIT MËSIMOR

1. Vendimi për përdorimin e orëve të lira me qëllim përforcimin e lëndës merret nga mësuesi i lëndës.
2. Mësuesi ka të drejtë të përdorë për këtë qëllim jo më shumë se 1/3 e orëve të lira të lëndës që zhvillon duke e marrë këtë vendim para fillimit të vitit shkollor.  
Në fillim të vitit shkollor, mësuesi nuk përcakton se kur do t'i përdorë këto orë, por vetëm sasinë e këtyre orëve. (Ai mund të vendosë t'i përdorë të gjitha këto orë, ose një pjesë të tyre, ose asnjë orë).
3. Mësuesi ka të drejtë të përdorë nga këto orë:
  - a) Në një kapitull ose linjë lëndore kur konstaton se një pjesë e nxënësve nuk kanë arritur objektivat minimale të domosdoshme të kapitullit ose linjës;
  - b) Për të zhvilluar orë plotësuese me një pjesë të nxënësve, ata me vështirësi në të nxënë.
4. Mësuesi shënon në regjistër, në lëndën përkatëse dhe kapitullin ose linjën lëndore përkatëse orën (orët) e lira, që ka përdorur për përforcim, në datën që i përdor.
5. Mësuesi nuk i përdor këto orë për të zëvendësuar orët e planifikuara në program, të cilat nuk i ka zhvilluar për arsye shëndetësore ose ndonjë arsye tjetër që nuk lidhet me mësimdhënien.
6. Përveç orëve që çdo mësues lëndor i planifikon për përforcim, orët e tjera të lira të një klase bashkohen dhe mund të planifikohen për:
  - A) projekte kurrikulare,
  - B) module mësimore,
  - C) lëndë me zgjedhje
  - D) veprimtari të ndryshme shkollore,
  - E) vlerësime në nivel shkolle të arritjeve të nxënësve.

## KREU IV

### PROJEKTET KURRIKULARE

1. Projektet kurrikulare mund:
  - a) Të porositen nga shkolla në Institutin e Kurrikulave dhe Trajnimit (IKT).
  - b) Të ideohen nga vetë shkolla.
  - c) Të porositen tek OJF, shkolla të larta ose organizma të tjera ose ideohen dhe zbatohen në bashkëpunim me ta.
2. Tematika të parapëlqyera të projekteve kurrikulare përfshijnë disa lëndë.
3. Zhvillimi i një projekti mund të ketë nevojë për shpenzime financiare. Në këtë rast shkolla mund:
  - a) Të aplikojë për fonde pranë MASH-it, DAR/ZA, fondacioneve, biznesit lokal, etj.
  - b) Të përdorë kontributet e komunitetit shkollor.
  - c) Të përdorë të ardhurat e saj nga shërbimet ndaj të tretëve.

## **KREU V**

### **MODULET MËSIMORE**

Modulet mësimore mund:

- a) Të porositen në IKT,
- b) Të hartohen nga grupe pune me mësues dhe specialistë,
- c) Të përshtaten nga programet lëndore të shkollave profesionale.

## **KREU VI**

### **LËNDËT ME ZGJEDHJE**

Programi i lëndëve me zgjedhje hartohet nga IKT.

Shkolla, që merr nismën dhe ka mundësitë për të zhvilluar lëndë me zgjedhje, kërkon zyrtarisht miratimin e DAR përkatëse.

## **KREU VII**

### **VEPRIMTARI TË NDRYSHME SHKOLLORE**

Shkolla ka të drejtë të përdorë ndër orët e lira veprimtari të tilla si konkurse, piknikë, ceremoni, angazhime në komunitetin e saj, etj.

## **KREU XIII**

### **VLERËSIME NË NIVEL TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE**

Shkolla ka të drejtë të planifikojë testime të klasave të ndryshme në periudha të caktuara, si në fund të semestrit të parë, në fund të vitit shkollor ose në fillim të vitit. Orë të lira mund të përdoren edhe për vlerësime të jashtme të arritjeve të nxënësve të planifikuara nga DAR/ZA ose institucionet qendrore.

## **KREU IX**

### **NGRITJA E EKIPIT TE KURRIKULËS**

1. Në çdo shkollë ngrihet ekipi i kurrikulës.
2. Ekipi i kurrikulës përbëhet nga kryetarët e ekipeve lëndore (departamenteve) dhe kryesohet nga një nëndrejtor kur ka të tillë ose drejtori kur nuk ka nëndrejtor.
3. Ekipi i kurrikulës:
  - a) Harton planin e përdorimit të të gjitha orëve të lira.
  - b) Ndhmon mësuesit në realizimin e orëve të lira.
  - c) Vëzhgon mësuesit në përdorimin e orëve të lira.
  - d) Bashkëpunon me shkolla të tjera për projekte kurrikulare ose module mësimore.

4. Ekipi i kurrikulës mbledhet çdo tre muaj gjatë vitit shkollor për të shqyrtuar mbarëvajtjen e përdorimit të orëve të lira sipas planifikimit dhe ndërmerr ose i propozon drejtorit të shkollës veprimtari që synojnë përmirësime (trajtime të personelit mësimor, ndryshime në projekte, etj.).

## **KREU X**

### **PROCEDURAT E PLANIFIKIMIT TË ORËVE TË LIRA**

1. Ekipi i kurrikulës kryen funksionet e mëposhtme:
  - a) Në bashkëpunim me mësuesit kujdestarë, zhvillon biseda dhe pyetësorë me nxënës dhe prindër të shkollës rreth tematikës së mundshme të projekteve kurrikulare e moduleve mësimore;
  - b) Bisedon me përfaqësues të qeverisë përkatëse lokale dhe DAR ose ZAsë përkatëse mbi parapëlqimet e tyre për projektet kurrikulare ose modulet mësimore.
2. Secili ekip lëndor (departament) zhvillon një mbledhje të posaçme mbi planifikimin e orëve të lira, në të cilën:
  - a) Çdo mësues njofton për numrin e orëve të lira që ka planifikuar për përforcimin e secilës lëndë që zhvillon;
  - b) Përzgjedh projekte kurrikulare ose module mësimore të ofruara nga IKT, OJF ose organizma të tjera;
  - c) Propozon projekte të tjera kurrikulare, module të tjera mësimore, veprimtari të ndryshme shkollore dhe vlerësime në nivel shkolle të arritjeve të nxënësve.
3. Përfundimet e mbledhjes së ekipit lëndor i dërgohen me shkrim ekipit kurrikular.
4. Ekipi i kurrikulës harton draft-planin vjetor të përdorimit të orëve të lira i cili përmban:
  - a) Numrin e orëve për përforcim nga secili mësues për secilën lëndë që zhvillon.
  - b) Listën e projekteve kurrikulare dhe moduleve mësimore të cilat shkolla do t'i porosisë.
  - c) Listën e projekteve kurrikulare që shkolla do të ideojë vetë, bashkë me temën, objektivat, një përmbledhje të përmbajtjes, lëndët që përfshihen në projekt, kohëzgjatjen, mjetet dhe buxhetin në total.
  - d) Planin e veprimtarive të ndryshme shkollore.
  - e) Planin e shkollës për vlerësimin e arritjeve të nxënësve.
  - f) Lëndët me zgjedhje (nëse ofrohen) për të cilat duhet të japë miratimin Drejtoria Arsimore Rajonale/Zyra Arsimore përkatëse.
5. Ekipi i kurrikulës i parashtron draft-planin trupës mësimore dhe më pas harton draftin e përmirësuar të cilin ja paraqet drejtorit të shkollës.
6. Drejtori i shkollës, bashkë me kryetarin e ekipit të kurrikulës, i parashtron draftin bordit të shkollës.
7. Pas miratimit nga bordi i shkollës, drejtori i shkollës njofton zyrtarisht Drejtorinë Arsimore Rajonale/Zyrën Arsimore për projektet kurrikulare, modulet mësimore dhe lëndët me zgjedhje për vitin shkollor.

## **KREU XI**

### **KRITERE PËR PROJEKTET KURRIKULARE, MODULET MËSIMORE DHE LËNDËT ME ZGJEDHJE**

1. Tematika e projekteve kurrikulare, moduleve mësimore, lëndëve me zgjedhje, veprimtarive të tjera mësimore përzgjidhet duke pasur parasysh:
  - a) Interesat e nxënësve e të prindërve,
  - b) Veçoritë e zhvillimit ekonomik, social e kulturor të zonës shkollore,
  - c) Parapëlqimet e mësuesve,
  - d) Mundësitë e mësuesve e të shkollës në realizimin e tyre.
2. Nga projektet kurrikulare duhet të përfitojnë të gjithë nxënësit e klasës së përfshirë në projekt.

## **KREU XII**

### **INSTITUTI I KURRIKULËS DHE TRAJNIMEVE:**

Detyrat e Institutit të Kurrikulës dhe Trajnimeve janë si më poshtë:

- a) Boton në gazetën “Mësuesi” ose u dërgon Drejtorive Arsimore Rajonale/Zyrave Arsimore projektet kurrikulare që ofron.
- b) Lehtëson informimin e shkollave në gjetjen e partnerëve për projekte kurrikulare ose module mësimore.
- c) Harton programe të trajnimit të mësuesve për hartimin dhe zhvillimin e projekteve kurrikulare, zhvillimin e moduleve mësimore dhe të lëndëve me zgjedhje.

## **KREU XIII**

### **DREJTORIA ARSIMORE RAJONALE/ZYRA ARSIMORE**

Detyrat e Drejtorisë Arsimore Rajonale/Zyrës Arsimore janë si më poshtë:

- a) Lehtëson informimin e shkollave në gjetjen e partnerëve për projekte kurrikulare dhe module mësimore.
- b) Harton programe të trajnimit të mësuesve për hartimin dhe zhvillimin e projekteve kurrikulare, të moduleve mësimore dhe lëndëve me zgjedhje.
- c) Ndhmon shkollat në:
  - I. Hartimin e projekteve kurrikulare dhe zbatimin e tyre;
  - II. Zhvillimin e moduleve mësimore dhe zbatimin e tyre;
  - III. Bashkërendimin ndërmjet shkollave për projekte të caktuara kurrikulare.

## **KREU XIV**

### **INSPEKTIMI**

Drejtoria e Inspektimit në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, ka për detyrë inspektimin e shkollës për respektimin e procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim.

## **KREU XV**

### **DISPOZITAT E FUNDIT**

Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Zëvendësministri për arsimin parauniversitar, Drejtoria e Kurrikulave, dhe çdo Drejtori Arsimore Rajonale dhe Zyrë Arsimore.

## **GENC POLLO**

## **M I N I S T È R**

	(Emër Mbiemër)	Nënshkrimi	Data
Konceptoi:	Suzana Tabaku, Fatmir Bezati		10.10.2007
Dr. i Drejtorisë:	Suzana Tabaku		10.10.2007
Dr. Juridike:	Rudin Baqli		.10.2007
Zëvendësministri	Halit Shamata		.10.2007
Sekretare e Përgjithshme:	Antonieta Luli		.10.2007